

## Kosovo Improvement Through Education (KITE)

Programi i Përmirësimit të Kosovës përmes Edukimit (PPKE apo KITE) ka për qëllim të krijojë përmirësime afat-shkurëtra dhe afat-mesme në performancën e bizneseve dhe OJQ-ve në mënyrë që ta asgjësojë ndikimin e krizës globale financiare. Këto përmirësime do të jenë rezultatet direkte të trajnimeve të disenjuara në bazë të kërkesave si dhe me mentorim për stafin e bizneseve dhe të OJQ-ve.

Qëllimi përfundimtar i programit KITE është ofrimi i elementeve të nevojshme për bizneset dhe OJQ-të në mënyrë që ato të ngriten në kapacitet, kualitet dhe kuantitet të shërbimeve që i ofrojnë, si dhe ta ngrisin fuqinë punëtore.



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo  
Kosovo Foundation for Open Society

**Burimi i Fondeve:** Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)

**Pjesëmarrësit me të drejtë aplikimi:** Staf i bizneseve dhe OJQ-ve kosovare që mund të përfitojnë nga trajnimet teknike dhe ato specifike për industrinë.

**Procesi i aplikimit:** Nga bizneset dhe OJQ-të do të kërkohet t'i vlerësojnë nevojat e tyre, t'i identifikojnë dhe nominojnë anëtarët e stafit të cilët do të mund të përfitojnë nga trajnimet specifike dhe të disenjuara në bazë të kërkesave.

**Llojet e trajnimeve që do të ofrohen:** Programet do të përqëndrohen drejt bizneseve dhe OJQ-ve në mënyrë që ato ta risin nivelin e menaxhmentit dhe të kapaciteteve teknike me qëllim të ngritjes së konkurrencës dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Trajnimet do të krijojnë në bazë të kërkesës së aplikantëve, por edhe mund të përqëndrohen në teknologji informative, ngritje fondesh nga donatorë të mëdhenjë, planifikim strategjik, qeverisje, komunikim, planifikim buxhetor, menaxhim të riskut, etj.

- **Programe mbi aftësim profesional në universitete të SHBA-së, kolegje të komuniteteve, apo institue trajnimesh me periudhë zgjatjeje deri më gjashtë muaj:** Këto mundësi edukimi do t'i ofrojnë stafit kosovar dituritë teknike, të aplikueshme në një fushë të caktuar. Stafit do të kthehet në biznesin apo organizatën përkatëse me dituri të nevojshme, për shembull, për përdorim apo edhe riparim të një aparati të caktuar, implementim të një përvojë të re biznesi, apo edhe aftësi planifikimi mbi zgjerimin e biznesit në fushë të re dhe me aktivitete të reja.
- **Trajnime 1-2 javore me mentorim në vend:** Këto trajnime do t'i ndihmojnë bizneset dhe organizatat që kanë përvojë teknike relevante, por kanë mungesë të vizionit strategjik për ta implementuar atë në mënyrë të duhur.
- **Trajnime afat-shkurtëra në vend, të krijuara në bazë të kërkesave të caktuara:** Nëse një numër i caktuar i bizneseve, organizatave paraqesin nevojë për një aftësim të caktuar, një ekspert do të silltet në Kosovë për ta mbajtur trajnimin në vend.

Për më tepër informata mbi Programin KITE, kontaktoni Saroj Siegler në [ssiegler@americancouncils.org](mailto:ssiegler@americancouncils.org) apo zyrën në Prishtinë në [kite@americancouncilssee.org](mailto:kite@americancouncilssee.org).